

POETI QË PËSOI NGA KUAJT

Nuanca letrare rreth poezisë "KUAJT" të Gjekë Marinajt

botuar në rivistën „DRITA” nr.33 (1554), 19 gusht 1990

Ndoshta mund të duket paksa absurd titulli i këtij vështrimi rreth poezisë (me titull „Napsurd”, „KUAJT” të Gjekë Marinajt.

Apsurditeti shkon deri atje kur kuptohet se çfarë gjërash absurde ndodhën pas botimit të kësaj poezie në rivistën „DRITA”, nr. 33, më 19 gusht 1990, Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

Viti 1990: Në fundgushtin e atij viti në faqen e dhjetë të revistës prezantohet poeti Gjekë Marinaj me katër poezi në rubrikën „Autorë të rinj”. Poeti Ndoc Gjetja bënë një prezentim të autorit në të cilin thuhet: „Një ditë, në klubin e Lidhjes së Shkrimtarëve tek po bisedonim me shkrimtarët Nasi Lera e Zija Çela, njohëm Gjekë Marinajn, një djalosh 22-vjeçar nga Bajza e Kastratit të Shkodrës. Patëm rastin të zbulojmë tek ai poetin nga leximi i fletorese së tij poetike të cilën mezi ia „xhvatëm” duke thyer „barrierën” e modestisë. „Merre Ndoci, se ty të takon t'ia kthesh kënaqësinë që na dhuroi leximi i poezive të tij më të mira”, – më tha Nasi Lera. Dhe unë po kryej porosinë pa shtërzim në marrëdhënie me vetveten, sepse poezitë e tij më pëlqyen dhe pashë tek ai filletarin e jorëndomtë. Nuk po flas për vlerat e poezive të Gjekës. Jam i bindur se nuk po tregohem një ndërmjetës i keq apo sentimental në mes poetit të ri dhe gazetës „Drita” e lexuesve”.

Cikli në përbënin poezitë: „Mos më ik larg, poezi”; „Vonesa e motrës”; „Të paktën në ëndërr...” dhe ajo „Kujat”. Ky cikël shquhet për një ligjerim të rrjedhshëm me shenja premtuese se Gjekja do të mirrej seriozisht me poezinë. Për mua atë kohë as më shumë e as më pak poezia në fjalë nuk më bëri përshtypje sepse nuk imagjinoja realitetin në Shqipëri. Në të vërtetë unë e imagjinoja Shqipërinë me një rend shoqëror ndër më të ngriturin, ku dallimet mes klasave janë të pa evitueshme kurse artit dhe vlerave gjithmonë iu ipej rëndësi primare. Kaq? Viti 1991: Po në rivistën „Drita” nr.22 (1595), të datës 30 qershor 1991, në faqen e katërt prezantohen me nga një poezi poetët: Adem Istrefi, Preç Zogaj, Ndoc Gjetja, Natasha Lako dhe Gjekë Marinaj me poezinë „KUAJT”. Poezive të këtyre autorëve iu paraprinte eseu i shkurtër i Rudolf Markut me titull „SFIDA POETIKE”, shkrim i cili më tërhoqi vëmendjen për ta lexuar më mirë poezinë në fjalë. Mes tjerash R.Marku shkruan: „Tani, në klimën e demokracisë, shkrimtarët do ta kenë shumë herë më të lehtë... Kështu mendojnë pak a shumë njerëzit – dashamirës, të cilët kullojnë jo pa rënqethje atë perden e hekurit me të cilën gjendje të ndryshonte ligjet e artit...”

Në kushtet e diktaturës, poezia shquhet, njëra ndër poezitë më të vjetra të konti-

nentit, provoi të mbijetonte, falë zgjuarsisë së saj, rebelizmit fisnik, elokuencës jotribunale, njeridashjes plot dhëmbshuri, intuitës së pagabueshme për të qenë moderne. Kjo është dhe arsyeja përse poezia shquhet shihej me sy të keq nga pushtetmbajtësit partiak, përse anatomohej nëpër Plenumë (veçanërisht në Plenumin e Katërt), përse shauhej nga kritikët, nga publicistët banalë, nga estetët mediokër, nga shkrimtarët e presidiumeve etatiste. Njëri nga autorët e përfshirë këtu, më i riu nga të gjithë, për poezinë që po i ribotojmë, u thirr në Degën e Brendshme të Shkodrës dhe u kërcënuar me zhdukje fizike. Poeti i ri njëzet vjeçar u detyrua të kapërcejë kufirin, edhe pse kjo gjë aso kohe mund të paguhej me kokë. Është vetëm njëri ndër shembujt që dëshmon se poezia e botuar kalonte kalvarin e vet”.

Më pastaj leximi i disahershëm i kësaj poezie bëri që të më ngulitet në mendje emri i autorit nga i cili nuk pata rastin më të lexojë qoft edhe


një varg. Ndonëse raportet politike ndryshuan në Shqipëri, shenjat e një meteori të ri që u shfaq në atë kohë u zbehën deri në venitje të plotë, ashtu siç nuk arrita të mësoj për demin politik që i paska shoqërisë shqiptare kjo poezi, si dhe nuk arrita të mësoj për fatin e autorit!

Viti 1996: Nga Kanada bie në telefonatë, ishte mikja ime, poetesha Life Hasa nga Malësia e Madhe e cila ishte vendosur në Toronto për disa kohë. Ajo më bëri të ditur se në Dallas të Amerikës do të botohet në të dy gjuhët revista për kulturë „KOHË E POETËVE” të cilën do ta drejton poeti Gjekë Marinaj. Lifja më foli me rrespekt për të duke insi-

stuar që të shkruaja për këtë revistë. Së shpejti do ta nisë një letër vet poeti Marinaj, më tregoi se Ai ka të botuar libër me poezi të cilin me siguri do ta dërgon edhe ty. Më foli shumë, kurse mua më sillje nëpër kokë ky emër pa ndërperer. Nuk arrita (aty për aty), ta përcaktoj se për cilin poet ishte fjalë.

Në muajin nëntor mora letër nga Amerika dhe bashkë me të librin „MOS MË IK LARG” të Gjekë Marinajt. Në kopertinë e librit ishin paraqitur tre kuajt të harbuar. Harbimi i këtyre tre kuajve vënë në ballë të librit nuk përkonte me titullin sepse në raste të tilla, bile duhej përdorur shumësi „Mos më ikni larg”, me gjithatë ky titull vjen nga një poezi tjetër që nuk ka të bëjë me kuajt e pikturuar në anën ballore të kopertinës, së librit. Ende e kisha të fiksuar faqen e parë të kopertinës, kur vërejtja se në anën tjetër (po në kopertinë), ishte vendosur poezia „KUAJT” që bashkrëndonte me faqen e parë. Me ta lexuar këtë poezi, arrita ta zbrërthej atë enigmën që mu pat krijuar kur më foli mikja ime nga Torontoja. Tashmë poezinë e kisha të njohur fare mirë. Jo nga rasti i parë, po më shumë nga rasti i dytë, kur Rudolf Marku e potenco i duke e shpjeguar fatin e autorit tek eseu „Sfida poetike”.

Poezia:



Poezia „Kuajt” e Gjekë Marinajt, ngërthen përmbajtjen e ndjenjave dhe të problemeve shpirtërore të shoqërisë shqiptare në fillim të viteve '90-ta, si dhe paraqet zemërimin e autorit me vokacionet dhe provokacionet e jetës, duke ia mundësuar atij që të shprehë mjaftë shlishtë botën e tij të mbrendshme përmes vargut poetik. Në planin artistik poezia nuk mund të veçohet as të rreshtohet ndër poezitë më të mira të shkruara gjatë asaj kohe. Vargu i kësaj poezie është i çiltër ku e përcjellin çrregullsitë e sistemit. Ata zëra vinin të çmendur dhe në çdo moment duhej të ndodhte e papritura. Veprimi i autorit për t'iu rreshtur rrezikut del si hapi më i mençur i asaj kohe për të ikur kontaktit me ata që hingëllinin se „qemë dhe mbetëm kuaj, para njeriut!”.

Shefqet Dibrani

NË BKUK U PROMOVUA LIBRI "LUTJE PËR DITËN E TETË TË JAVËS" TË AUTORIT GJEKË MARINAJ


POEZIA E MARINAJT, POEZI E KONCEPTIVE, NOCIONEVE DHE IDEVE

Prishtinë, 26 maj

Në Bibliotekën Kombëtare e Universitare të Kosovës, organizuar nga Shtëpia Botuese "Faiik Komica" të Prishtinës, u promovua libri me poezi "Lutje për ditën e tetë të javës", të autorit Gjekë Marinaj, i cili jeton dhe vepron në Amerikë. Promovimin e këtij libri e udhëhoqi shkrimtari Nazmi Rrahmani.

Kritiku dhe publicisti i njohur nga Shqipëria, z. Mujë Mucpapaj, duke folur për vlerat ideocartistike të këtij libri theksoi se poezia e shkrimtari Gjekë Marinaj, i pëket shkollës evropiane por është përpunuar në shkollën amerikane. "Në këtë libër, ka theksuar Bucpapaj, Marinaj, ka eksperimentuar duke krijuar një kod të ri për letërsinë tonë. Poezia e Marinaj është mjaft interesante që ngërthen në vete disa cikle që krijtojnë një tërësi unike përmbajtësore. Metafora, si formë stilistike përkohet pohlunajse në gjithë poezinë e tij. Poezia e tij mban shumë emociione. Në ciklin e tretë të këtij libri, "Lutjet e së dielës", është një poezi që poeti e trajton temën e

fshatit. Këtë temë autori Marinaj e trajton në mënyrën më të qëndrueshme. Ndërkaq, në kapitullin e katërt "Duart e nënës", konceptojnë dashuritë humane e njerëzore. Figura e nënës vë në piedestal të himnizimit të saj. Po ashtu edhe në kapitullin vijues "Retërimi i Rozalës", autori Rozalën si mit yni e sheh në mënyrë mjaft origjinale. Poezia e Marinaj ka një mësim të jashtëzakonshëm, poezi kjo që në vete përmban një lëndë plot universalitet, ka theksuar Bucpapaj. Me këtë rasi kritiku i njohur, Ramadan Musiu, duke folur për vlerat e këtij vëllimi poetik theksoi se me Gjekë Marinajn dhe poezinë e tij kam kontaktuar shumë herët. Në këtë vëllim poetik, është shprehur Musiu, më ka bërë përshtypje. Pse dita e tetë e javës kur dimë që jawa ka shtatë ditë? Duke komunikuar me ide të imazhet, mesazhet eji, e pashtë që kultura jonë i ka kaluar disa faza. Autori, Marinaj, ka theksuar ai, në këtë libër e përkujton edhe poezinë e Naim Frashërit, duke ruajtur po atë konfiguracion. "Është një poezi intelektuale që jam



përpjekur që ta definoj që kemi një shkollë të lartë të abstraksionit. Kemi një zbulje në një plazmë poetik. Në poezinë e Marinaj hasim disa koncepte bazë filozofike. Kemi poezi të ndfeshme, me një fuqi të madhe konceptuale që mund konceptin. Në këtë poezi autori ka dhënë realizim të dorës së parë. Gjekë Marinaj, duke shkruar për Shqipërinë dhe Kosovën ka arritur të na thotë se poet kombëtar, pra poet që ka tabanin nacional. Poezia e Marinaj, është një poezi e koncepteve, nocioneve dhe ideve, ku gëshehohen nëpër vija të ndryshme. Në

këtë varg kemi një mbyqje të romantikës. Poezia e Marinaj, në letratona sjell një mendim të ri, një konceptualitet të ri që dallohet nga Reshpija, Camraj e të tjerë", tha ai. Me këtë poezi, ka theksuar Musiu, Marinaj na dha të komunikojnë me një poezi të reja me vlerat e reja, ka theksuar Musiu. "Poezia e Marinaj, në pjesën më të madhe është reflektive, përkaktësisht meditative, për të mos thënë edhe me nuanca të poezisë filozofike, ka theksuar në fjalën e tij kritiku Ali D. Jasiqi dhe vazhdoi: "Gjekë Marinaj do të meditojë me shumë probleme jetësore për qëndrimin e njeriut ndaj dukurive të ndryshme në natyrë dhe përgjithësisht në jetë. Do të meditojë edhe për qëndrimin e vet ndaj dukurive e fenomeneve të ndryshme; do të meditojë për qëndrimin që duhet mbajtur në situata të caktuara", është shprehur kritiku Jasiqi.

Në fund shkrimtari Gjekë Marinaj i falenderoi të pranishmit. Ai ndër të tjerat u shpreh: "Kosova është pjesë e madhe e esencës së poezisë sime".

Mikel Gajani

Kanë, 26 maj
Filmi francez "Midis mureve" ka fituar Palmën e Artë si filmi më i mirë në festivalin ndërkombëtar të filmi në Kanë të Francës. Filmi është realizuar me një numër nënësish, të gjithë aktorë amatorë dhe tregon mjedisin e vështrirë në një shkollë franceze. Gmimi i madh i festivalet i shkoi italianit Mateo Garrone për filmin

"Gomorrah" që llet për mafien. Regjisor i mirë u shpall turku Nuri Bilge Cylan për filmin e tij

"Tre majmunë". Benicio del Toro u shpall aktori më i mirë për rolin e Ce Gevatis në filmin epik të

titulluar "Ce". Sandra Corveloni u ndertua si aktoria më e mirë e festivalet për rolin në filmin brazilian

"Line of Passage". Skenari më i mirë u shpall ai i filmi "Heshija e Lomës", ku luajnë edhe dy aktorë të Kosovës: Arta Dobrosht dhe Alban Ukaj. Madje Arta Dobrosht ishte pretendente për Palmën e artë për rolin më të mirë të femrës. Gnimet për aktivitetin jetësor iu dhanë veteraneve të filmit, francezes Katrinë Denev dhe amerikant Klint Istvud./B.5.

E martë 27 maj 2008

25